



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 636 / prot.

2

Tiranë, më 07.11.2024

VENDIM

Nr. 1126, Datë 07.11.2024

**“PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE
TË PËRQENDRIMIT TË NDËRMARRJEVE”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

| | | |
|------|----------------|------------|
| Z. | Denar BIBA | Kryetar |
| Znj. | Leida MATJA | Zv/Kryetar |
| Znj. | Rezana KONOMI | Anëtar |
| Z. | Durim Kraja | Anëtar |
| Znj. | Fatjola DELIJA | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 07.11.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e një ndryshimi në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, germa d) dhe dh), neni 26 dhe neni 84, germa c), Kodi i Procedurave Administrative; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE :

Autoriteti i Konkurrencës, realizon procedurat e kontrollit të përqendrimeve për transaksione të cilat plotësojnë kriteret e nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në rastet e bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve, të përfutimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të krijimit një ndërmarrje e përbashkët etj.

Në zbatim të nenit 4 “Caktimi i tarifave për ndjekjen e procedurave në rastet e kontrollit të përqendrimeve” të Rregullores “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës aplikon tarifa për njoftimin dhe autorizimin e transaksioneve. Në disa raste, pala njoftuese ka shfaqur vonesa në pagesën e tarifave.

Ligji nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” dhe rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, nuk kanë të parashikuar në mënyrë të veçantë zgjidhjen e një situate të tillë dhe për rastet të cilat nuk parashikohen nga ligji nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës, zbaton Kodin e Procedurave Administrative.

Në nenin 96 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se: “Procedura e nisur me kërkesë, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, si pasojë e mospagimit brenda afatit të përcaktuar, të tarifave, pagimi i të cilave, sipas ligjit është kusht për nxjerrjen e vendimit përfundimtar, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në këtë Kod...”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d) dhe dh), neni 24 dhe neni 84 germa c), të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”:

VENDOSI:

1. Ndryshimin e Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” si më poshtë:

Në nenin 11 “Data kur njoftimi bëhet efektiv” të Rregullores, pas pikës 6 shtohet pika 7 me përmbajtje:

7. Procedura e kontrollit të përqendrimeve, fillon me kërkesë të palës njoftuese ose kryesisht nga Autoriteti i Konkurrencës dhe përfundon me nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga Komisioni i Konkurrencës, pasi të jenë kryer pagesat e parashikuara në Rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Pagesa e tarifës së përqendrimeve duhet të kryhet nga pala njoftuese brenda një muaji nga data e lëshimit të faturës.

Mospagimi i plotë i këtyre pagesave do të konsiderohet braktisje e procedurës dhe përqendrim i panjoftuar. Në këtë rast, Autoriteti i Konkurrencës i deklaron palës njoftuese përfundimin e procedurës me akt administrativ të nënshkruar nga Kryetari.


2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e vendimit.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA

Zv/Kryetar

Rezana KONOMI

Anëtar

Durim KRAJA

Anëtar

Fatjola DELIJA

Anëtar

Denar BIBA

Kryetar

